



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:120739

Datë: 14.02.2024

Numri i dokumentit: 05325444

P.nr.317/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit Z. A., për shkak të veprës penale “Kanosja” nga neni 181 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.323/2023F, të datës 23.06.2023, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të hapur për publikun, të mbajtur me datë 08.02.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Rukije Sheshivari, të dëmtuarës S. P., të pandehurit dhe mbrojtësit të tij av. M. N. sipas autorizimit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 14.02.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

1. Z. A., nga i ati F. dhe nëna E., mbiemri i vajzërisë së nënës B., data e lindjes ... në P., me vendbanim në Rr. “...”, p.nr. Lagja “...”, P., letërnjoftimi ..., ka të kryer shkollën fillore, Hotelieri, kafiteria “...”, P., i martuar, baba i pesë (5) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në paraburgim nga data 30.05.2023, deri me datë 27.06.2023.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

I. Me datë 27.05.2023, rreth orës 18:22, në lagjen e K. në P., konkretisht në shtëpinë e motrës së të dëmtuarës, për shkak të mosmarrëveshjeve të vazhdueshme me të dëmtuarën – bashkëjetuesen e tij S. P., i njëjti ka ushtruar dhunë psikike ndaj të dëmtuarës, me qëllim të cenimit të dinjitetit të saj, në atë mënyrë, e dëmtuara duke qëndruar te motra e saj, pas dhunës së ushtruar psikike të papërballueshme nga ana e të pandehurit, i njëjti i mllefosur nga braktisja e të dëmtuarës, i ka dërguar SMS kërcënuese, me përmbajtje “Nuk guxon që të punosh askund”, “Qile telefonin, mos të vi atje”, kurse me 17.05.2023, rreth orës 04:51, derisa e dëmtuara ka qenë te nëna në fshatin L., i pandehuri i ka dërguar SMS me përmbajtje kërcënuese, “Po ty kam me të vra, ku të zatetit, ti pos në shpi ki me nejt, edhe ski qare pa ma hjek akuzën në gjygj, qysh ma ke hjek me gjithë vlla tanin, se ju vras të dyve”, “Se ti nuk e din kush osht Z. hajni i Vranjevcit”, Edhe sa her të

thom kthehu, ki mu kthye, se tmyt, dije veq minati të maj, jo që due, po veq me lue me ty”, “Se unë mirna me krejt sene, se kom pare sa dush, për ty jom zot, unë qata të maj me zor, unë ty, se ti me vlla tanin, nuk pat qare pa ma hjek akuzën, se ju vras dyve, e nuk ma nin hiq, se une familjen teme e kom, e ty veq me hup kohë, edhe mos me tlan rahat kërkun, jo që due, po veq minati” e tjera fjalë kërcënuese, dhe si pasojë e këtyre veprimeve, të dëmtuarës i ka shkaktuar ndjenjën e frikës, ankthit dhe të pasigurisë për jetë.

- me këtë ka kryer veprën penale “Kanosja” nga neni 181 par. 2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70 dhe 79 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 367 dhe 449 të KPP-së, të pandehurin e:

G J Y K O N M E D Ë N I M M E G J O B Ë

I. Ashtu që i cakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muaj, në kuadër të cilit do t’i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 30.05.2023, deri me datë 27.06.2023.

II. Me pëlqimin e të dënuarit, pjesa e mbetur e dënimit me burgim i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej pesëqind (500) Euro, të cilën detyrohet ta paguajë brenda afatit prej tre (3) muajsh, në dy (2) këste të barabarta, ashtu që këstin e parë brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse i pandehuri nuk paguan këstin me kohë, ndërsa nëse i njëjti nuk e paguan gjobën në shumën e përgjithshme të përcaktuar si në pikën (II) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, atëherë ky dënim me gjobë do t’i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo njëzet (20) Euro të dënimit me gjobë, do t’i llogaritet një (1) ditë burgim.

IV. DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale / paushallë të paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) Euro dhe në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej njëzet (20) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

V. E dëmtuara S. P., me vendbanim në Rr. “...” në P., nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP/II.nr.323/2023F, të datës 23.06.2023, kundër të pandehurit Z. A., për shkak të veprës penale “Kanosja” nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 26.12.2023, prokurori i shteti ka bërë rikualifikimin juridik të veprës penale duke mënjanuar paragrafin 4 të nenit 181 të KPRK-së, ndërsa në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 08.02.2024, pas marrjes në pyetje të dëmtuarës – dëshmitares S. P. si dhe prezantimit të provave materiale, në kuptim të nenit 343 par. 1 të KPP-së, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me marrjen në pyetje të pandehurit.

I pandehuri Z. A. në seancën e shqyrtimit gjyqësor te datës 08.02.2024 pasi më parë është njoftuar për të drejtat e tij i njëjti është deklaruar fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar duke shtuar se ndjen keqardhje për veprimet e tij të ndërmarra dhe përkundër asaj se ka shënuar mesazhe me të dëmtuarën me të cilën ka bashkëjetuar që pesë (5) vite, nuk ka pasur për qëllim që ta kanosë apo ti shkaktojë ndonjë të keqe të dëmtuarës, premtion se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla apo të kryej vepër penale, tani me të dëmtuarën janë pajtuar edhe familjarisht, nuk kanë pasur probleme që nga dita kur rasti ka ndodhur, janë takuar disa herë, rrethana këto për të cilat kërkoi nga gjykata shqiptimin e një sanksioni më të butë penal.

Gjykata në kuptim të nenit 322 par.1 konstatoi se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par.1 të KPP-së, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj gjatë marrjes në konsideratë të pranimit të fajësisë nga i pandehuri, mori mendimin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit të pandehurit dhe të dëmtuarës.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, sepse pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, pranimi i fajësisë ka mbështetje në shkresat e lëndës dhe është në përputhje me dispozitat ligjore të KPP-së, andaj ka propozuar që gjykata ta pranojë pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të pandehurit av. M. N., lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij ka deklaruar se pajtohet plotësisht me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, pasi që të njëjtin e ka bërë në mënyrë vullnetare duke qenë i informuar lidhur me pasojat dhe favorin e pranimit të fajësisë dhe se ky pranim ka mbështetje në provat që gjenden në aktakuzë.

E dëmtuara S. P. lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, shtoi se tërhiqet nga ndjekja penale dhe kërkoi që i njëjti të lirohet nga dënimi pasi që tashmë janë pajtuar si dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, mbrojtësit të pandehurit dhe të dëmtuarës, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, është pranuar edhe gjendja faktike si në dispozitiv të aktakuzës dhe rrjedhimisht kjo gjendje faktike ka mbështetje edhe në provat të cilat janë propozuar në aktakuzë, prandaj në kuptim të nenit 322 par. 4 të KPP-së pasi vlerësoi se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 2 të KPP-së, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: Mbetet pranë aktakuzës, gjatë këtij shqyrtimi se i pandehuri e ka kryer veprën penale “Kanosja” nga neni 181 par.2 të KPRK-së, fakt i cili është vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga vet i pandehuri, andaj i propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe dënojë sipas ligjit, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese si dhe ato rënduese.

E dëmtuara S. P. në fjalën përfundimtare deklaroi: Meqenëse tani me të pandehurin me të cilin kam bashkëjetuar për pesë (5) vite dhe se tashmë janë pajtuar familjarisht, me të njëjtin nuk kanë pasur më asnjë problem që nga rasti i ndodhur, nga gjykata kërkoi që të njëjtin ta lirojë nga akuzat.

Mbrojtësi i të pandehurit Z. A., av. M. N., në fjalën përfundimtare ka deklaruar: Pasi që i mbrojturi im e ka pranuar fajësinë, gjykatës i propozoi që me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit të merr për bazë rrethanat lehtësuese siç janë: pranimin e fajësisë, pendimin e kryerjes së veprës penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla, keqardhjen e shprehur për palën e dëmtuar, qëndrimin korrekt të tij në gjykatë, ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese të merr për bazë faktin se e dëmtuara nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale, nuk parashtron kërkesë pasurore juridike dhe se tashmë janë pajtuar, andaj gjykatës i propozoj që të njëjtit ti shqiptojë një dënim sa më të butë, duke pasur parasysh faktin se i njëjti ka qëndruar në masën e paraburgimit një (1) muaj.

I pandehuri në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: E mbështetë fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i pandehuri, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurit të ndërmarra në kuadër të dashjes së tij, manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale “Kanosja” nga neni 181 par. 2 të KPRK-së dhe pasi që më parë gjeti se në aspektin penal-juridik është përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që në rastin konkret si rrethana lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen dhe pendesën e tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, tani me të dëmtuarën janë pajtuar gjë që kjo e fundit e pohoi me vet deklarimin e saj e cila kërkoi që i njëjti të lirohet, ndërsa si rrethana rënduese nuk gjeti, andaj nga arsyet dhe rrethanat e sipërtheksuara gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është adekuat dhe në proporcion me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, me bindje se një dënim i tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë në kryerjen e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi llogaritjen e kohës së kaluar në ndalim në dënimin e shqiptuar me burgim është marrë në bazë të nenit 79 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë me pëlqimin e të dënuarit është marrë në bazë të nenit 44 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në bazë të nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale/paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 452 par. 1 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par. 3 nën-par. 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr. 317/23, Datë 14.02.2024

Procesmbajtëse
Erblina Aliu

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik SHEQIRI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.